

UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT PËR REGJISTRIMIN E MARKËS TREGTARE

Procedura e regjistrimit fillon me dorëzimin e formularit të plotësuar në Zyrën për Pronësi Industriale.

Formulari merret në Zyrën për Pronësi Industriale në MTI, apo nga web-site zyrtar i MTI-së : www.mti-ks.org

Formulari për regjistrimin e markës tregtare plotësohet në gjuhën shqipe vetëm me kompjuter apo makinë shkrimi. Formulari nuk duhet të plotësohet me dorë.

Disa shpjegime për plotësimin e këtij formulari:

Rubrika 2

Emri, mbiemri (për personin fizik), emri i plotë (për personin juridik) adresa (të dhënat të shënohen sipas radhës) : rruga, numri, numri postar, qyteti, shteti, vendqëndrimi, selia, tel/fax dhe e-mail adresa.

Rubrika 3- Të dhënat për përfaqësuesin

Emri dhe mbiemri (për personin fizik), për personin juridik (emri i plotë i personit juridik), adresa; rruga ,numri, numri postar, qyteti, shteti, tel, telefax, e-mail adresa.

Rubrika 4- Të dhënat për shenjën

Në këtë rubrikë janë të shënuara llojet e formave të markave tregtare. Varësisht nga lloji shënohet tipi apo lloji i markës.

Dukja e shenjës së markës tregtare duhet të jetë e fiksuar në formularë me përmasa maksimale 8x8 cm .

Në rastet kur marka është e përbashkët kolektive dhe certifikuese është e domosdoshme të dorëzohet kontrata e shfrytëzimit.

Rubrika 5- Klasifikimi

Duhet rrethuar numri i klasës për produkte dhe shërbime sipas klasifikimit të Nicës.

Në faqen shtesë shënohet lista e produkteve apo shërbimeve për të cilat kërkohet mbrojtja.

Rubrika 6- E drejta e përparësisë

Nëse kërkohet njohja e të drejtës së përparësisë që i referohet formularit të dorëzuar më përpara, shënohen këto të dhëna: emri i organit dhe vendi ku është paraqitur formulari i mëparshëm, numri dhe data e dorëzimit.

Nëse kërkohet njohja e të drejtës së përparësisë që i referohet pjesëmarrjes, përkatësisht ekspozimit të produkteve në ndonjë ekspozitë ndërkombëtare, shënohen këto të dhëna: emri i ekspozitës, vendi i mbajtjes dhe data e paraqitjes në ekspozitë.

Rubrika 7- Deklarata e shfrytëzimit

Duhet të tregohet së Marka tregtare është duke u shfrytëzuar apo jo.

Rubrika 8- Adresa për kontakte

Nëse paraqitësi i formularit ka caktuar ndonjë person tjetër për të kontaktuar me palë, shënohen emri dhe mbiemri i atij personi, nr. i telefonit, telefaxit, e-mail dhe adresa.

Rubrika 9- Shtojcat që i bashkëngjiten formularit

Shënohen në katror përkatës:

Lista e produkteve dhe e shërbimeve, autorizimi, kontrata për markën kolektive, kontrata për markën certifikuese, dëshmia mbi të drejtën e përparësisë, dëshmia mbi pagesën e taksës administrative, numri i faqeve shpesh të paraqitura për pikat e shënuara në formular, numri i faqeve që përmban kërkesa dhe numrin e faqeve që i bashkëngjiten formularit.

Formulari i plotësuar për regjistrimin e markës tregtare duhet ta ketë vulën e titullarit dhe nënshkrimin e tij apo të përfaqësuesit ndërsa, me rastin e dorëzimit, nënshkruhet dhe vulolet nga zyrtari i Zyrës për Pronësi Industriale.